



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____ .2022

VENDIM
Nr. 63, datë 17.02.2022

PËR

CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

V E N D O S I :

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Arben Lera, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen penale me të pandehur: {...}: Akuza: “Nenet 109/1 e 25 dhe 297 të Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LEZHË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Sokol Shehu, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen penale me të pandehur: {...}dhe {...}; Akuza: “Dërgim në gjyq”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TROPOJË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, Florin Demollari, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë; Objekti: “Kërkesë për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr.124 viti 2018 në ngarkim të të pandehurit {...}, akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Alda Sadiku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 100/2 i Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR GJIROKASTËR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Gjergji Baçi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjirokastrë; Objekti: “Dërgim i çështjes në gjyq.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elbana Lluri, gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Iliba Bezati, Margarita Buhali dhe Sokol Ngresi si dhe gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Enton Dhimitri, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Person i tretë: {...}; Objekti: “Sigurimin e padisë duke vendosur pezullimin e punimeve jashtë gjurmës së pasurisë nr.43/1, caktuar me Vendimin nr.82, datë 31.01.2020 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njesinë administrative Baldushk, Bashkia Tiranë”.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, Astrit Kalaja dhe Valbona Vata, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit, çështjen civile me Paditës: {...}; E paditur: {...}; Objekti: “Shfuqizimin e pikës së 3-të të seksionit B, kreu X të shprehur në pikën nr.4 të vendimit nr. 528, datë 10.11.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 75 datë 23.05.2019 të KLGj-së”. Shfuqizimin e pikës 7 të seksionit B, kreu X, të Vendimit të KLGj-së nr.75 datë 23.05.2019 “Për procedurat e verifikimeve të kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtar për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë”. Detyrimin e KLGJ-së për të pezulluar zbatimin e vendimeve objekt gjykimi për pikat e kundërshtuara deri në përfundimin të shqyrtimit gjyqësor. Pagimin e shpenzimeve gjyqësore”.

GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Enton Dhimitri dhe Sokol Pina, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve”.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Enton Dhimitri dhe Sokol Pina, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}; Akuza: “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve”.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Enton Dhimitri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit, në formën e mbajtjes pa leje të armëve”.

4. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Enton Dhimitri dhe Sokol Pina, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale

me të pandehur: {...}; Akuza: “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”; “Largim nga vendi i aksidentit”.

5. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Sokol Pina, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”.

GJYKATA E APELIT SHKODËR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës, Irida Kacerja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur {...}, etj.; Akuza: “Nenet 76 e 278/1 të Kodit Penal”.

GJYKATA E APELIT DURRËS

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, Valbona Vata, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 143/2 i Kodit Penal”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, Valbona Vata, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 120/2 i Kodit Penal”.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, Valbona Vata, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen penale me të pandehur: {...} dhe {...}; Akuza: “Neni 298/3 të Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR